



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Bordi Qeverisës i KPMM-se ne përputhje me nenin 2 te Ligjit 03/L-081 për ndryshimin e Rregullores 2005/2 për Themelimin e Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale, me date 27.03.2009, me qellim te rregullimit te përpilimit te projekteve minerare dhe personave përgjegjës për aktivitetet e nevojshme në industrinë minerare nxjerr këtë udhëzim:

UDHEZIM PËR LICENCIMIN E KOMPANIVE PROJEKTUESE DHE PËRSONAVE PËRGJEGJËS NE SEKTORIN MINERAR

Neni 1

1.1. Hulumtimet gjeologjike, hartimin e projekteve të hulumtimeve gjeologjike dhe të elaboreteve për rezultatet e hulumtimeve gjeologjike; hartimin e projekteve të xehetarisë dhe teknologjike, mund t'i kryej personi juridik që është i regjistruar në autoritetin përkatës për regjistrimin e biznesit për kryerjen e asaj veprimtarie dhe që ka të punësuar me kualifikim superior shkollor të degës së gjeologjisë dhe xehetarisë, të cilët kanë autorizimin për kryerjen e atyre punëve.

1.2. Punët e udhëheqjes së hulumtimeve gjeologjike dhe xehetare, përpilimin e dokumentacionit teknik dhe kryerjen e vlerësimit profesional - revidimit (të programeve, të projekteve dhe elaboreteve), mund ta kryej personi i cili, përveç kushteve nga paragrafi 1.1 i këtij neni, ka së paku 3 vjet përvojë pune në kryerjen e punëve përkatëse dhe me autorizim për kryerjen e atyre punëve (i certifikuar).

1.3. Autorizimi për kryerjen e punëve nga paragrafi 1.1- 1.2 të këtij neni dhe të punëve tjera profesionale të përcaktuara me këtë vendim, fitohet me dhënien e provimit profesional, i cili epet para komisionit të cilin me propozim te Drejtorit e aprovon Bordi i KPMM.

1.4. Hartimin e dokumentacioneve teknike nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni mund të realizojnë edhe peronat juridikë të huaj që janë të regjistruar në autoritetin përkatës për regjistrimin e biznesit në Kosovë dhe të cilët posedojnë licencë valide nga shteti i tyre.

Neni 2

2.1. Me vendim të veçantë të Bordit të KPMM formohet komisioni për vlerësimin e kandidatëve për certifikim.

2.2. Komisioni përbëhet nga Kryetari i komisionit dhe dy anëtarë tjerë.

2.3. Nga një anëtar i komisionit propozohet nga MEM dhe KPMM, ndërsa anëtari i tretë mund të jetë përfaqësues i fakulteteve apo edhe nga shoqatat gjegjëse.

2.3. Kryetari i komisionit emërtohet nga lamia përkatëse,

2.4. Kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit i takon kompensimi, vlera e të cilit caktohet me vendimin për emërimin e komisionit.

2.5 Nëse MEM brenda afatit të caktuar nuk cakton anëtarin e komisionit në përputhje me nenin 2.3, atëherë Drejtori i KPMM-se i propozon Bordit një anëtarë të ri.

Certifikimi i kandidatëve

Neni 3

3.1 Për certifikim sipas kësaj rregulloreje kanë të drejtë të paraqiten vetëm kandidatët që paraprakisht kanë të përfunduar fakultetin e gjeologjisë, xehetarisë dhe drejtimet e ndërlidhura me aktivitetet minerare, e të cilët kanë titullin inxhinier i diplomuar dhe së paku 3 vjet përvojë pune në kryerjen e punëve përkatëse profesionale.

3.2. Provimi profesional jepet sipas programit të përcaktuar nga komisioni.

3.3. Shpenzimet për licencim i bartë personi i cili i parashtrohet provimit për licencim (kandidati) apo kompania, përkatësisht personi juridik ku kandidati është i punësuar.

Neni 4

4.1. Kërkesën për të ju parashtruar provimit profesional, kandidati e paraqet me shkrim në shërbimin përkatës në KPMM. Kërkesës duhet bashkëngjitur edhe:

1. Certifikatën e lindjes,
2. Diplomën apo kopjen e diplomës së vërtetuar,
3. Vërtetimin mbi përvojën përkatëse të punës
4. CV e kandidatit.

Neni 5

5.1. Komisioni pas vlerësimit të kërkesave, e informon kandidatin se i ka plotësuar kushtet për të ju parashtruar provimit profesional, si dhe cakton temën dhe afatin për dorëzimin e temës me shkrim. Temën mund ta propozoi edhe vet kandidati apo kompania

ku është i punësuar. Tema në formë të shkruar duhet të dorëzohet së paku 15 ditë para datës së provimit profesional.

5.2 Kandidatet i nënshtrohen edhe pyetjeve në lidhje me legjislacionin në fuqi nga sektori minerar në Kosovë si dhe standardet ndërkombëtare të këtij sektori.

5.3 Për kandidatet të cilët posedojnë grada shkencore nën 5.1 nuk aplikohet (nuk është i nevojshëm).

5.4. Nëse kandidati nuk i parashtrohet provimit profesional apo nëse para provimit deklarohet që heq dorë nga provimi, do të konsiderohet që nuk i është parashtruar provimit.

5.5. Nëse kandidati pa arsye tërhiqet nga provimi profesional i cili ka filluar, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

5.6. Puna e komisionit raportohet në formën e shkruar, i cili raport do të jetë bazë për lëshimin e certifikatës për kandidatin. Raporti duhet të jetë i firmosur nga kryetari dhe anëtarët e komisionit.

Neni 6

6.1. Personat fizik, banor të Kosovës, të cilët posedojnë vërtetim-dëshmi për dhënien e provimit profesional duhet të aplikojnë për marrjen e certifikatës së re.

6.2. Personat fizikë të cilët posedojnë certifikatë të vlefshme nga shtetet tjera, dhe kanë për qëllim që të merren me këtë veprimtari edhe përmes firmave në Kosovë, duhet që të bëjnë nostrifikimin e certifikatës.

6.3. Nostrifikimin e bënë komisioni për certifikim.

6.4. Parashtruesi i kërkesës për nostrifikim duhet të paraqesë dëshmi valide mbi posedimin e këtij dokumenti.

6.5. Për aplikim nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paguhet kompensimi në shumë prej 20 €

6.6. Për nostrifikim nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të paguhet kompensimi në shumë prej 100 €

Neni 7

Certifikatën e lëshon KPMM-ja në bazë të kërkesës dhe raportit të komisionit certifikues.

Licencimi i subjekteve juridike

Neni 8

8.1. Për licencim kanë të drejtë të paraqiten personat juridik të cilët janë të regjistruar për kryerjen e punëve nga paragrafi 2 i nenit 1 të kësaj rregulloreje dhe mund të pajisen me licencë adekuate nëse:

a) Për marrjen e licencës për xehetari kompania duhet të ketë së paku dy (2) inxhinier të diplomuar të xehetarisë, të cilët janë të pajisur me certifikata individuale.

b) Për marrjen e licencës për gjeologji kompania duhet të ketë së paku dy (2) inxhinier të diplomuar të gjeologjisë, të cilët janë të pajisur me certifikata individuale.

c) Për marrjen e licencës për veprimtari tjera sipas paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, kompania duhet të ketë nga një (1) inxhinier të diplomuar nga lëmia përkatëse, të cilët janë të pajisur me certifikata individuale.

d) Kompania mund të pajiset me një licencë për të gjitha veprimtarit nën a, b, c, apo edhe ndarazi.

8.2. Licenca epet në afat prej 5 vitesh, dhe vërtetohet çdo vit. ,

8.3 Vërtetimi i licencës behet me aprovimin paraprak te zyrës ligjore pran KPMM-se se ndaj poseduesit te licencës nuk ka ndonjë ndalese te punës nga Bordi i KPMM-se.

8.4 Evidencën e licencave të dhëna e mbanë KPMM-ja.

8.5. Për dhënien e licencës paguhet kompensimi në shumë prej 500 euro, kurse për vërtetim kompensimi në shumë prej 100 euro.

8.6. Mjetet nga kompensimet nga paragrafi i mësipërm janë të hyra në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

8.7. Bartësi i licencës është i detyruar që për çdo ndryshim të njoftoi KPMM, në afat prej 8 ditësh nga dita e ndryshimit të kushteve.

Projekti i hulumtimeve gjeologjike

Neni 9

Hulumtimet gjeologjike kryhen në bazë të projektit, i cili përmban:

- a) detyrën projektuese,
- b) të dhënat e përgjithshme të hapësirës hulumtuese,
- c) historiku i studiushmërisë,
- d) zgjidhja projektuese e procesit të hulumtimeve gjeologjike,
- e) specifikimi i punimeve sipas llojit dhe vëllimit,
- f) paralogaritja financiare e punimeve,

- g) dinamika e realizimit të punimeve me afatet e përfundimit të tyre,
- h) përshkrimin mbi ndikimin e mundësive negative në mjedis si dhe masat e parapara për minimizimin apo evitimin e ndikimeve eventuale gjatë dhe pas kryerjes së punëve hulumtuese,
- i) mbrojtjes në punë, si dhe
- j) kushtet tjera të përcaktuara me ligj.

Elaborati i rezultateve të hulumtimeve gjeologjike

Neni 10

Elaborati mbi rezultatet e hulumtimeve gjeologjike, përkatësisht mbi rezervat e lëndëve të para minerale, i cili hartohet pas përfundimit të hulumtimeve gjeologjike të paraparë me projektin për hulumtim, përmban:

- a. pasqyrimin dhe vlerësimin e hulumtimeve të mëhershme;
- b. qëllimi dhe mënyra e hulumtimit;
- c. paraqitja e sistemuar e shënimeve të fituara me hulumtimet në terren;
- d. pasqyrimi dhe interpretimi i rezultateve të hulumtimeve;
- e. paraqitja e rezervave të lëndëve të para minerale (sipas rregulloreve për klasifikimin dhe verifikimin e rezervave në fuqi apo standardeve ndërkombëtare të aplikuara në Kosovë), kushtet e eksploatimit dhe masat e mbrojtjes së mjedisit si dhe
- f. vlerësimi tekniko-ekonomik i rezultateve të hulumtimit.

Projektet e xehetarisë

Neni 11

11.1. Për nevojat e zhvillimit të aktiviteteve minerare duhet të realizohen projektet si në vijim:

- A. Projekti kryesor xehetarisë;
- B. Projekti plotësues i xehetarisë;
- C. Projekti i thjeshtësuar i xehetarisë;
- D. Projekti për mbylljen e minierës.

11.2. Hartimi i dokumentacionit teknik sipas pikave (A), (B), (C) dhe (D) të paragrafit (1) të këtij neni bëhet vetëm nga subjektet projektuese të licencuara nga KPMM, duke i

përfshirë edhe personat juridikë të huaj që janë të regjistruar në autoritetin përkatës për regjistrimin e biznesit në Kosovë dhe të cilët posedojnë licencë valide nga shteti i tyre.

Vlerësimi profesional (revidimi) i dokumentacionit gjeologjik dhe i projekteve minerare

Neni 12

12.1. Elaborati gjeologjik sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje dhe projektet nga paragrafi (1) sipas pikave (A), (B) dhe (D) të nenit 11, i nënshtrohen vlerësimit profesional (revidimit). Vlerësimin profesional (revidimin) mund ta kryej vetëm personi juridik i licencuar për këtë veprimtari.

12.2. Vlerësimi profesional - revidimi nga paragrafi 1 i këtij neni përfshinë kontrollin në kuptimin e përmbajtjes nga neni 10 dhe 11 i kësaj rregulloreje mbi aplikimin e të arriturave bashkëkohore në lëmin gjeologo-minerare dhe teknikës në pajtim me përshkrimet e caktuara, rregulloret teknike, standardet, si dhe kontrolli në kuptimin e aplikimit të masave dhe normave për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjes në punë, sigurimit të objekteve, njerëzve dhe objekteve fqinje.

12.3. Vlerësimin profesional - revidimin e projekteve nuk mund ta kryej:

- a. personi juridik i cili e ka hartuar këtë projekt dhe personi juridik që është kryerës i hulumtimeve;
- b. personi i punësuar në ndërmarrje apo personi tjetër juridik që e ka hartuar projektin apo ka marrë pjesë në hartimin e këtij projekti;
- c. personi që është i punësuar tek kryerësi i hulumtimeve;
- d. personi i punësuar në institucionin kompetent për lëshimin e licencave;

Raport i vlerësimit profesional (revidimit) dhe klauzolë revidimi

Neni 13

13.1. Personi juridik apo fizik i cili ka kryer vlerësimin profesional të dokumentacionit gjeologjik gjegjësisht projekteve minerare në kuptim të nenit 10 dhe 11 të kësaj rregulloreje, përgatit raportin e vlerësimit profesional dhe jep klauzolë revidimi me të cilën vërtetohet se dokumentacioni gjeologjik gjegjësisht projektet minerare janë të përpiluara në përputhje me këtë rregullore dhe dispozitat e parapara ligjore.

13.2. Klauzolën e revidimit e nënshkruan personi përgjegjës i personit juridik apo fizik i cili ka kryer vlerësimin profesional.

13.3. Në klauzolën e revidimit patjetër duhet të shënohet personi i cili e ka kryer vlerësimin profesional mbi projektin në përputhje me dispozitat e parapara ligjore.

13.4. Me klauzolën e revidimit në KPMM dorëzohet edhe kopje të dëshmive për personat juridik ose fizik lidhur me licencat dhe autorizimet e poseduara për përpilimin e dokumentacionit gjeologjik, përkatësisht projekteve minerare dhe dëshmitë nga autorizimi ose licencave për personat që kanë kryer vlerësimin profesional (revidimin).

13.5. Nëse vlerësimin profesional e disa pjesëve të projektit e kanë kryer më shumë persona, në klauzolën e revidimit patjetër duhet të theksohet veç e veç se cilët persona në cilat pjesë të projektit e kanë kryer vlerësimin profesional.

Udhëheqja dhe mbikëqyrja teknike

Neni 14

14.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje gjatë punës.

14.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i gjeologjisë dhe xehetarisë (Becheler), i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

14.3. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

14.4. Një person përgjegjës i kompanive mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni më së shumti për dy (2) kompani minerare.

Neni 15

15.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e guroreve me kapacitet me të vogël se 100 000 m³ ne vit, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje gjatë punës.

15.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i gjeologjisë dhe xehetarisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

15.3. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë në një kompani minerare.

15.4. Një person përgjegjës i kompanive mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 16

16.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e guroreve me kapacitet mbi 100 000 m³ ne vit, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje gjatë punës.

16.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

16.3. Raportimin e rezervave për këtë kategori duhet të kryejë inxhinieri i gjeologjisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

16.4. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë në një kompani minerare.

16.5. Personat kompetent të sipas paragrafëve 2, 3 të këtij neni mund të mbulojnë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 17

17.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e resurseve minerale metalike, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së aktiviteteve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje gjatë punës.

17.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i lamisë së caktuar, i cili posedon autorizim për kryerjen e aktiviteteve të tilla.

17.3. Autorizimin për kryerjen e aktiviteteve minerare lëshohet sipas procedurave të parashikuara me këtë rregullore.

17.4. Një person përgjegjës i kompanive mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 18

18.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në proceset teknologjike të përpunimit të lëndëve të para minerale, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së aktiviteteve sipas projekteve përkatëse, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje gjatë punës.

18.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, gjeologjisë dhe inxhinieri lemisë gjegjëse, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

18.3. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë në një kompani minerare.

18.4. Një person përgjegjës i kompanive mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani.